



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 94/1 Prot.

Tiranë, më 13.01.2021

V E N D I M

Nr. 05, Datë 13.01.2021

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 120, datë 20.10.2020, e D.P kundër Shoqërisë ALBtelecom sh.a, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 22.10.2020, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Prej më shumë se 11 vitesh është i punësuar pranë Altelecom sh.a, dhe vitet e fundit në pozicionin si, Specialist Arkive pranë Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit, Departamenti i Shërbimeve ndaj Klientit. Gjatë tre viteve të fundit për shkak të problemeve me shëndetin është deklaruar nga KEMP-I (Komisioni i Ekspertimit Mjeko-Punëtor) si invalid i pjesshëm që duhet të punojë 6 orë pune në profesion. Me shkresën nr. 6120, datë 01.10.2020 “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” është njoftuar se në kuadër të ndryshimit të strukturës organizative të Shoqërisë Altelecom sh.a, pozicioni i tij i punës është shkurtuar dhe marrëdhëniet e punës do të përfundojnë në datë 31.12.2020. Sapo ka marrë njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me e-mail-in datë 02.10.2020 i është drejtuar, Drejtores*

¹ Referuar Urdhër Paguese datë 19.04.2019 dhe datë 23.04.2020 të lëshuar nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore Tiranë, D.P me nr. pensioni 262754, është deklaruar nga KEMP-I si invalid i pjesshëm me konditë që të punojë 6 orë pune në profesion dhe diferenca e pagës mbulohet nga sigurimet shoqërore.

së Njësisë së Burimeve Njerëzore, të cilën e ka kujtuar se ai, si rezultat i gjendjes shëndetësore i nënshtrohet rregjimit të punës prej 6 orësh. Gjithashtu ankuesi në datë 05.10.2020 ka kërkuar takim me Drejtorin e Njësisë, E.H dhe I.B të cilët e informuan se grupi ku ai punonte prej 3 punonjësish ishte suprimuar dhe se puna do ti kalonte kolegëve të ngelur në Njësinë e Arkivimit. Më pas ankuesi i është drejtuar me shkrim Administratorit të Shoqërisë, në të cilën e ka vënë në dijeni për situatën e tij, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe e ka informuar se në kompani ka dhe punonjës të tjerë të cilët në vite janë mbrojtur nga reformat e kryera si pasojë e rekomandimit të KMCAP-së. Me Shkresën nr. 6167/1, datë 12.10.2020, Administratori i Shoqërisë e ka informuar se përkatësia e një individi në kategori të veçantë nuk është kushti i vetëm i cili përcakton detyrimin e Albtelecom për të punësuar apo mbajtur të punësuar individë të veçantë. Ankuesi informon se në muajin shkurt në njësinë ku punonte, është shtuar një kolege e re (L.K) e cila nuk është përfshirë në DL (Distribution List), po kryente një pjesë të punës (vetëm një nga proceset që ata kryenin) dhe pas suprimimit të DL-së është e vetmja punonjëse që Ekipi i Arkivimit e ka mbajtur për të kryer këto procese (vetting prepaid). Ankuesi shprehet se është një nga punonjësit më të vlerësuar përsa i përket performancës në punë dhe çuditërisht ai largohet dhe zëvendësohet me një punonjëse të sapo ardhur pa experiencë dhe sigurisht, ndryshe nga ai, më e aftë nga ana shëndetësore. Ankuesi deklaron se në shkresën nr.6120, datë 01.10.2020 “Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, vëren se ndërmjet punëdhënësit dhe sindikatës² është nënshkruar marrëveshja nr.5924, datë 23.09.2020 e cila nuk i është bërë e ditur nga punëdhënësi edhe pse ai nuk është anëtarë i sindikatës, por punëdhënësi ka detyrim ligjor që të njoftojë punëmarrësin përpara procesit të ristrukturimit”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe vazhdimin e marrëdhënieve të punësimit pranë Shoqërisë Albtelecom sh.a.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

² Sindikata e Punonjësve Postë&Telekomit Shqiptar.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 120, datë 20.10.2020, të D.P u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1424/1, datë 27.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria ALBtelecom sh.a për ankesën e bërë nga D.P si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të emërimit dhe të procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të D.P, kopje të kontratës dhe përkrahimit të punës.
 - Shpjegime mbi pretendimet e ankuesit lidhur me marrëdhëniet e punësimit të L.K, kopje të plotë të emërimit të punonjësës L.K, kopje të kontratës dhe përkrahimit të punës.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të Departamentit të Shërbimeve ndaj Klientit.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së re të Departamentit të Shërbimeve ndaj Klientit.
 - Kopje të studimit të bërë mbi ristrukturimin e institucionit dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do largoheshin apo ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit.
 - Kopje të Rregullores së Brendëshme të Shoqërisë dhe të Kontratës Kolektive.
 - Kopje të procedurës së ndjekur për negociimin me sindikatën të pushimit kolektiv dhe Kopje të Akt-marrëveshjes për Pushimet Kolektive nr. 5924, datë 23.09.2020.
 - Shpjegime të politikave që ndjek Shoqëria Albtelecom sh.a për punësimin e personave nga grupet e veçanta, në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 15, datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit”.
 - Informacion për punonjës të tjerë që trajtohen me KEMP dhe KMCAP që janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për arsye të ristrukturimit në Departamentin e Shërbimeve ndaj Klientit.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitin 2018, 2019 dhe 6-mujorin e I-2020 dhe të masave disiplinore për punonjësën D.P.

Me shkresën nr. 6802/1, datë 11.11.2020, Albtelecom sh.a, në mes të tjerash informoi se: *“Albtelecom sh.a. është një shoqëri që ka të punësuar një numër relativisht të madh punonjësish. D.P ka qenë i punësuar pranë shoqërisë Albtelecom sh.a duke kryer disa detyra, dhe së fundmi në pozicionin e Specialistit pranë Skuadrës së Faturimit dhe Arkivimit, Departamenti i Shërbimit të Klientit, Grupi Komercial. Marrëdhëniet e punës me D.P, si punëmarrës janë rregulluar me “Kontratë Individuale Pune me Afat të Pacaktuar”, me Nr. 9434, datë 01.10.2018, si edhe me Kontratën Kolektive të shoqërisë Albtelecom sh.a, me Nr. 7262, datë 23.10.2019, lidhur midis punëdhënësit dhe përfaqësuesit të Sindikatës së Punonjësve të Postë&Telekomit Shqiptar. Për arsye të riorganizimit të proceseve të punës, ka ardhur si pasojë edhe dizenjimi i një strukture organizative të re, fleksibël dhe të përshtatshme për një treg dinamik, siç bëhet fjalë për tregun e komunikimeve elektronike. Kjo strukturë e re organizative synon të optimizojë proceset e punës duke reduktuar kostot e panevojshme dhe mundëson investime të reja dhe shërbime me tarifa të favorshme për pajtimtarët. Për këtë arsye Shoqëria Albtelecom sh.a ka ndërmarrë një reformë, për reduktimin e fuqisë punëtore nëpërmjet një procesi të rregullt sipas përcaktimeve ligjore. Shoqëria Albtelecom duke zbatuar rigorozisht përcaktimet e Kodit të Punës, si dhe kontratën kolektive filloi procedurat për pushimin kolektiv të punonjësve. Me Shkresën nr. 5095, datë 17.08.2020, Albtelecom i është drejtuar Sindikatës së Punonjësve të Postë Telekomit Shqiptar, për fillimin e negociatave për ristrukturimin e kompanisë Albtelecom. Procesi i ristrukturimit parashikonte largimin e 50 punonjësve të Albtelecom dhe periudha brenda të cilës do të realizohej kjo procedurë, do të ishte deri me 31 Dhjetor 2020. Albtelecom ftoi palët në takimin e datës 26.08.2020 me qëllim këshillimin dhe negocimin e kushteve për arritjen e një marrëveshje mbi pushimin kolektiv. Kjo shkresë gjithashtu është përcjellë për dijeni dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim njoftimin për fillimin e negociatave për ristrukturimin e kompanisë Albtelecom sh.a, në respektim të përcaktimeve ligjore. Për këtë arsye, përfaqësues të Albtelecom hynë në bisedime me përfaqësues të Sindikatës së Punonjësve të Post Telekomit Shqiptar. Në përfundim të bisedimeve u arrit të nënshkruhej një marrëveshje me Sindikatën, me Nr. 5924, datë 23.09.2020, për mënyrën e organizmit të reformës, reduktimin e fuqisë punëtore deri në 35 punonjës, si dhe përfitimet për punonjësit që do të dilnin në reformë. Në vijim të pushimit kolektiv, i cili ka përfshirë dhe Departamentin e Shërbimit të Klientit, Shoqëria Albtelecom përfundimisht ka njoftuar me shkresën nr.6120, datë 01.10.2020, D.P nëpërmjet të cilës i ka komunikuar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe të gjitha përfitimet sipas dispozitave ligjore të Kodit të Punës. Në referencë të nenin 143 të Kodit të Punës marrëdhëniet e punës me këtë punonjës do të ndërpriten në datë 31.12.2020 në respektim të afatit të njoftimit dhe deri në këtë datë D.P do vijojë të paguhet rregullisht. Ankuesi së bashku me punonjëset, A.Q dhe O.B, kanë qenë pjesë e Skuadrës së Faturimit, e të njëjtës njësi të quajtur “prepaid vetting team” (skuadra e vetingut të shërbimit me parapagesë), të cilët para vitit 2018 kanë qenë pjesë e Grupit të Financës dhe vetëm me datë 01.04.2018 i janë bashkuar Skuadrës së Faturimit dhe Arkivës, siç provohet dhe me shkresën e ndryshimit të pozicionit drejtuar D.P me nr, 2559, datë 20.03.2018. Në kuadër të pushimit kolektiv, pasi është bërë një analizë e përgjithshme, që ka lidhje me volumin e punës, numrin e punonjësve, punët e kryera, të kësaj*

skuaadre është arritur në konkluzion që duhet të ketë reduktime në staf. Duke qenë se ka patur një ulje të numrit të aktivizimeve të numrave mobile me parapagesë, automatikisht duke bërë uljen e volumit të punës, si dhe duke qenë se proceset e punës që kryeshin nga “prepaid vetting team”, kanë lidhje pikërisht me aktivizimin e numrave prepaid, atëherë u konkludua që e gjithë njësia “prepaid vetting team” të reduktohej. Këtu duhet të sqarohet dhe një fakt tjetër që aktualisht aktivizimi i numrave me parapagesë bëhet direkt në dyqanet e Albtelecom dhe njësia ku ka qenë pjesë ankuesi bënte validimin e këtij aktivizimi. Ndërkohë validimi i aktivizimit ezaurohet dhe në mënyrë optike dhe ky proces mbulohet nga pjesa tjetër e grupit të arkivës. Si rrjedhojë u vlerësua që i gjithë ky proces të kalojë në arkivë tek pjesa tjetër e stafit që tashmë e kryen këtë proces, duke shmangur kështu përsëritjen dhe dublimin e të njëjtës punë. Ashtu si evidentohet në strukturë para dhe pas pushimit kolektiv, Departamenti i Shërbimit të Klientit, Skuadra e Faturimit dhe Arkivës ka pasur gjithsej, 19 punonjës para reformës. Ndërkohë me organizimin e ri të punës, kjo skuadër është riorganizuar, duke shkurtuar gjithsej 7 punonjës, tashmë kanë mbetur 12 punonjës. Siç shihet reduktime ka patur dhe në tërësi të stafit të Skuadrës së Faturimit dhe Arkivës pasi janë shkurtuar gjithsej 7 punonjës. Me këtë strukturë Albtelecom provon, se në kuadër të ndryshimit të strukturës organizative të shoqërisë, vendi i punës i D.P është reduktuar dhe ky ka qenë shkaku për të cilën Albtelecom, ka zgjidhur marrëdhënien e punës me të. Siç u parashtrua dhe më sipër e gjithë njësia ku bënte pjesë D.P është shkurtuar, si rrjedhojë kanë qenë pjesë e pushimit kolektiv dhe punonjëset A.Q dhe O.B. Në këtë mënyrë është shkurtuar e gjithë njësia ku bënte pjesë D.P, dhe rezulton se ai nuk është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pra nuk është zgjedhur një tjetër të qëndrojë në vend të tij dhe të kryejë punën e tij, përkundrazi janë përfshirë në këtë reformë dhe i është shkurtuar vendi i punës dhe kolegeve të tij, që janë të së njëjtës njësi dhe kryenin të njëjtën punë. Lidhur me pretendimin për punonjësen L.K, sqarohet se ajo ka filluar punë në datë 27.08.2019, në pozicionin si specialiste në skuadrën e Menaxhimit të Vlerave të Klientëve, pranë Departamentit të Shërbimeve ndaj Klienteve, Grupi Tregëtar. Më pas në datë 04.01.2020 është emëruar specialiste pranë Skuadrës së Faturimit dhe Arkivës, Departamenti i Shërbimit të Klientit. Duke qenë se L.K ka qenë e re në këtë skuadër, është përfshirë në të gjitha proceset e punës në mënyrë që t'i përvetësonte të gjitha, sikurse çdo punonjës tjetër i stafit, por në asnjë rast nuk ka qenë pjesë e “Prepaid vetting team” (njësi ku ka qenë ankuesi), madje nuk është përfshirë as në adresën e e-mail-it të grupit (DL Prepaid Vetting Team). Shoqëria Albtelecom është një kompani e cila respekton në tërësi dhe me korrektësi të gjitha detyrimet e përcaktuara ligjore që kanë lidhje me punësimin dhe krijimin e kushteve të favorshme të punës për invalidët e vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse. Aktualisht pranë shoqërisë janë të punësuar edhe punonjës të tjerë që i përkasin kategorisë “grupe të veçanta”.

- Me shkresën nr. 1424/3, datë 10.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga Shoqëria Albtelecom si dhe ka kërkuar aktet e poshtërcituara:

- Cilat kanë qenë përpjekjet⁴ e Shoqërisë Altelecom për ta mbajtur në punë apo ripozicionuar D.P, sipas parashikimit në nenin 9 të Akt-Marrëveshjes nr. 5924, datë 23.09.2020?
- Emri/at e punonjësve që kanë përfituar sipas parashikimeve të bëra në nenin 9 të Akt-Marrëveshjes nr. 5924, datë 23.09.2020.
- Kush janë punonjësit e tjerë të punësuar pranë Shoqërisë Altelecom, që i përkasin “grupeve të veçanta⁵”, që janë larguar nga puna për shkak të ristrukturimit apo që vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit?
- Shpjegime të politikave që ndjek Shoqëria Altelecom sh.a për punësimin e personave nga grupet e veçanta, në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 15, datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit”.

Me shkresën nr. 6802/3, datë 17.12.2020, Shoqëria Altelecom, në mes të tjerash informoi se: *“Lidhur me përpjekjet e Shoqërisë Altelecom për të mbajtur në punë apo ripozicionuar D.P sipas parashikimit të nenin 9 të marrëveshjes nr. 5924, datë 23.09.2020, sqarojmë se D.P ë shtë punësuar pranë Altelecom sh.a me datë 15.06.2009, pranë strukturës së Kujdesit të Klientit në pozicionin e Specialistit të Arkivës. Gjatë marrëdhënies së tij të punës, struktura ku ka qenë pjesë, ka ndryshuar varësi disa herë, si rezultat i vendimmarrjes së manaxhimit të lartë me qëllim përmirësimin e proceseve të punës. Eksperinca e tij para se të transferohej sërish në skuadrën e Faturimit dhe të Arkivës ka qenë skuadra e Vetting, pranë Grupit të Financës. Gjatë periudhës së afatit të njoftimit të D.P, kanë qenë 7 pozicione vakante pranë shoqërisë Altelecom sh.a. Të gjitha këto pozicione janë vlerësuar nga ana e kompanisë dhe janë kryer të gjitha përpjekjet për të vlerësuar mundësinë e përshtatjes së D.P në këto pozicione, por asnjë prej tyre nuk është parë i përshtatshëm për ekperiencën dhe edukimin e tij. Shoqëria Altelecom, sjell në vëmendje se aktualisht pranë shoqërisë janë të punësuar disa punonjës që i përkasin kategorisë “grupe të veçanta”, të cilët trajtohen me KMCA, duke u kompensuar për 2 orë pune në ditë nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, ndërkohë që në kompani punojnë dhe kompensohen për 6 orë (I.T dhe A.L). Gjithashtu sa i takon politikave të kompanisë, vlen të përmendet edhe rasti i punonjësit J.Ç, i cili edhe pse nuk ka të depozituar pranë kompanisë dokumentacion invaliditeti, është rast i mbështetjes që kompania ka ofruar për një person me aftësi fizike të kufizuara. Gjithashtu, informojmë se nuk ka pasur punonjës të larguar me reformë me këtë status”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

⁴ Referuar deklarimeve të bëra në faqe 4, paragrafi 4, të Shkresës nr. 6802/1, datë 11.11.2020.

⁵ Referuar deklarimeve të bëra në faqe 6, paragrafi 2, të Shkresës nr. 6802/1, datë 11.11.2020.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankuesit për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për largimin e tij nga puna, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Subjekti ankues, nga data 15.06.2009 ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë Albletecom në pozicione të ndryshme, dhe nga data 01.10.2018 ka qenë i punësuar në pozicionin si Specialistit pranë Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit, Departamenti i Shërbimit ndaj Klientëve. Marrëdhëniet e punës me D.P, si punëmarrës janë rregulluar me “Kontratën Individuale të Punës me Afat të Pacaktuar”, nr. 9434, datë 01.10.2018, si edhe me Kontratën Kolektive të Shoqërisë Albletecom sh.a, me nr. 7262, datë 23.10.2019, lidhur mes punëdhënësit dhe përfaqësuesit të Sindikatës së Punonjësve të Postë&Telekomit Shqiptar.

Në pikën 11.1 të Kontratës Individuale të Punës, nr. 9434, datë 01.10.2018, të D.P, parashikohet se: *“11.1.1 Punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë në çdo kohë kontratën për shkaqe të justifikuara. Konsiderohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e parashikuara në Nenin 153/2 të Kodit të Punës, si edhe rastet si më poshtë vijojnë: b. Shpërndahet subjekti juridik, bëhen shkurtime në strukturë dhe në numrin e punonjësve, për shkak të kërkesave operacionale të Albletecom sh.a”.*

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se në zbatim të nenit 148 të Kodit të Punës, Shoqëria Albletecom me shkresën nr. 5095, datë 17.08.2020 i është drejtuar Sindikatës së Punonjësve të Postë & Telekomit Shqiptar, për fillimin e negociatave për ristrukturimin e Shoqërisë Albletecom, duke vënë në dijeni dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Në përfundim të bisedimeve mes Albletecom sh.a dhe Sindikatës së Punonjësve të Postë & Telekomit Shqiptar u arrit të nënshkruhej marrëveshja, nr. 5924, datë 23.09.2020, për mënyrën e organizmit të reformës, reduktimin e fuqisë punëtore, deri në 35 punonjës, si dhe përfitimet për punonjësit që do të dilnin në reformë.

Me shkresën nr. 5924/1, datë 29.09.2020, Shoqëria Albtelecom ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi përfundimin e këshillimeve për ristrukturimin e Shoqërisë Albtelecom dhe ka depozituar Akt-marrëveshjen nr. 5924, datë 23.09.2020. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces ristrukturimi që po ndodh në Shoqërinë Albtelecom, si pasojë e përmirësimit dhe modernizimit të shërbimeve të Shoqërisë Albtelecom me qëllim ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe me tarifa më konkurruese nga ana e shoqërisë për periudhën në vijim.

Në bazë të nenit 6 të Akt-Marrëveshjes së sipërpërmendur, kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, ishin: *“(i) Pozicioni i punës sipas organikës së re; (ii) Karriera e punonjësit dhe përshtatja e saj me funksionin që kryen; (iii) Performanca e punonjësit në rastet e reduktimit të numrit të punonjësve, përveç rastit kur shkurtohet tërësisht vendi i punës; dhe (iv) Punëdhënësi mund të konsiderojë mundësinë e ofrimit të vendeve vakante për punonjësit e përfshirë në reformë ose familjarët e tyre, në çdo rast në përputhje me pritshmëritë e kërkuara për këto pozicione vakante”.*

Përsa më sipër, nga ana e Shoqërisë Albtelecom, filloi procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me subjektin ankues. Kështu, me shkresën nr. 6120, datë 01.10.2020, D.P është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në datë 31.12.2020, në kuadër të ndryshimit të strukturës organizative të Shoqërisë Albtelecom.

Ankuesi, me shkresën nr. 6167, datë 05.10.2020 i është drejtuar Drejtores së Departamentit të Burimeve Njerëzore, të cilës i ka sjellë në vëmendje se për shkak të specifikës së tij, kompania duhet të jetë më sensitive në trajtimin e rastit të tij, si rezultat i gjendjes shëndetësore, pasi ai i nënshtrohet rregjimit të punës prej 6 orësh.

Shoqëria Albtelecom, me Shkresën nr. 6167/1, datë 12.10.2020, ka informuar ankuesin se, Albtelecom sh.a zbaton në tërësi dhe me korrektësi detyrimet në lidhje me punësimin dhe krijimin e kushteve të favorshme të punës për invalidët e vlerësuar pjesërisht të aftë për punë, por në asnjë rast përkatësia e një individi në kategori të veçanta nuk është kushti i vetëm i cili përcakton detyrimin e Albtelecom për të punësuar apo mbajtur të punësuar individë të veçantë.

Referuar strukturës organizative të mëparshme të Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit, vërtetohet se kjo skuadër përbëhet nga 19 punonjës gjithsej, dhe tre nga këto punonjës: D.P, A.Q dhe O.B, ishin pjesë e njësisë së vetingut të shërbimit me parapagesë (prepaid vetting team).

Referuar strukturës organizative të re të Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit, vërtetohet se kjo skuadër përbëhet nga 12 punonjës gjithsej, dhe tre punonjësit e njësisë së vetingut të shërbimit me parapagesë (prepaid vetting team), nuk figurojnë në këtë strukturë.

Përsa më sipër, evidentohet fakti se Ekipi i Faturimit dhe Arkivimit është reduktuar dhe tre punonjësit e njësisë së vetingut të shërbimit me parapagesë i janë nënshtuar procedurave ligjore të pushimit kolektiv nga puna.

Në lidhje me punonjësën, L.K të përmendur nga ankuesi dhe në analizë të dokumenteve të dorëzuara nga palët, vlerësohet se L.K ka filluar punë pranë Shoqërisë Altelecom në datë 27.08.2019⁶, në pozicionin si specialiste pranë Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit⁷.

Referuar përshkrimit të punës të njësisë së vetingut të shërbimit me parapagesë (prepaid vetting team), D.P ishte përgjegjës për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- Validimin 100% brenda një afati kohor prej 3 ditëve me zero gabime të gjithë biletave të hapura në sistem për aktivizimin e numrave mobile me parapagesë (Prepaid), pranë pikave Altelecom;
- Validimin 100% brenda një afati kohor prej 3 ditëve me zero gabime të gjithë biletave të hapura në sistem për aktivizimin e numrave mobile me parapagesë (Prepaid), pranë pikave të Distributoreve;
- Rregullimin dhe sistemin e të dhënave të abonentëve në sistem që kanë numra mobile me parapagesë sipas dokumentacionit të përcjellë me e-mail nga dyqanet brenda 48 orëve;
- Kalimi i kontratës (kalimi i numrit) nga njëri abonent tek tjetri sipas dokumentacionit të përcjellë me e-mail, brenda 24 orëve.

Referuar përshkrimit të punës, L.K ishte përgjegjëse për kryerjen e detyrave si më poshtë:

- Supervizimin e procesit të paketimit pranë kompanisë korriere; përgjegjëse për monitorimin e procesit të faturave biznes për Tiranën;
- Monitorimin e procesit të shpërndarjes të faturave me kompaninë korriere duke siguruar shpërndarjen 98% për faturat mobile dhe fix, brenda datës 23 të muajit;
- Përgjegjëse për dhënien e një informacioni të saktë për abonentët dhe departamentet e tjera në lidhje me ankesat e bëra, brenda afateve kohore, 24 deri në 72 orë;
- Përgjegjëse për procese të tjera sipas kërkesave brenda afateve;
- Përgjegjëse për përditësimin e të dhënave të abonentëve dhe përmirësimin e adresave të abonenteve.

Në analizë të pretendimit të ankuesit dhe të përshkrimit të punës së dy punonjësve, vlerësohet se detyrat e kryera nga punonjësja L.K janë të ndryshme dhe nuk përputhen me detyrat dhe pozicionin e punës së ankuesit. Në analizë të ndryshimeve në strukturën e Ekipit të Faturimit dhe Arkivimit dhe të pozicioneve të punës, vërehet se njësia e vetingut të shërbimit me parapagesë, që përbëhej nga tre punonjës, D.P, O.B dhe A.Q është reduktuar dhe nuk ekziston më dhe detyrat e kryera nga kjo njësi janë shpërndarë tek punonjësit e tjerë, ndërkohë që pozicioni i punës që mbulohej nga L.K ka vazhduar të jetë pjesë e strukturës dhe në vijim.

Pra, në këtë rast konstatohet se ankuesi është në të njëjtat kushte me punonjësit e tjerë të njësisë së vetingut të shërbimit me parapagesë, të cilët i janë nënshkruar procedurës së ristrukturimit të

⁶ Referuar Kontratës Individuale të Punës me Afat të Pacaktuar nr. 6053/1, datë 27.08.2019.

⁷ Referuar Formularit të Përshkrimit të Punës datë 04.01.2020, të L.K.

Shoqërisë Albtelecom dhe shkurtimit të pozicioneve të punës dhe nuk mund të krahasohet me punonjësen L.K të cilës nuk i është reduktuar vendi i punës.

Në përfundim, Komisioneri nuk konstaton se ankuesi të jetë ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë apo të pafavorshëm lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si pasojë e ndryshimit të strukturës organizative të Shoqërisë ALBtelecom sh.a për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në referencë të nenit 7, të LMD, Komisioneri gjykon se për sa i përket ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, D.P nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Shoqërisë ALBtelecom sh.a. Në mungesë të këtij trajtimi nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit D.P nga ana e Shoqërisë ALBtelecom sh.a, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA